## AKT THEMELIMI
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## "UNI TRADE LOGISTIC A.S." Sh.p.k

Ne Tirane, sot me datë 24/04/2023,

- Znj.Rudina Bregu person me shtetësi shqipëtare, e datëlindjes 03/10/1979. Mbajtës e kartës së identitetit me Nr. H95113050O.
- Znj.Nertila Spiri person me shtetësi shqipëtare, e datëlindjes 05/05/1971. Mbajtës e kartës së identitetit me Nr. H15505208W.
- Z.Julian Canka person me shtetësi shqipëtare, e datëlindjes 16/03/1981. Mbajtës e kartës së identitetit me Nr. I10316102F,

Te cilet me zotësi të plotë juridike per të vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"UNI TRADE LOGISTIC A.S."** Sh.p.k

**Neni 1**
**Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**
**Emertimi I shoqerise**
Emertimi i shoqerise eshte **"UNI TRADE LOGISTIC A.S."** Sh.p.k

**Neni 3**
**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

**Neni 4**

**Objekti I veprimtarise**

4.1 Veprimtaria e Shoqerisë **"UNI TRADE LOGISTIC A.S."** Sh.p.k do të ketë për objekt :

> **Kryerjen e të gjitha formaliteteve doganore për çdo lloj regjimi doganor në emër dhe për llogari të personave fizik dhe juridik. Import – eksport të të gjitha pajisjeve, makinerive e mallrave industriale dhe bujqësore. Spedicion mallrash për të tretë dhe për vete.**

**Agjensi detare. Import, Ri-export mallra industriale në zonë të lirë doganore, dhënie me qira kontiniere në zonë të lirë doganore, Durrës. Shërbime logjistike, shërbime magazinimi, kontenieri, magazinim dhe shpërndarje.**

4.2 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të Ortakeve mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortaket, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Ortakevet.

**Selia 5**

Selia e Shoqerise "**UNI TRADE LOGISTIC A.S.**" Sh.p.k eshte ne adresen:

Vore, Muçaj, Terminali Dogana e Tiranës, Tirane

Shoqeria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit.

**Neni 6**
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

**Neni 7**
**Kapitali i shoqerise**

**7.1.** Kapitali themeltar i shoqerise "**UNI TRADE LOGISTIC A.S.**" Sh.p.k është 100.000(njëqindmijë) Leke.
**7.2.** Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njeqindemije) Leke dhe eshte i ndare ne 3 (tre) kuota.

• **Znj.Rudina Bregu** - Zotëron 33.33 % te kapitalit fillestar e barabarte me 1 kuotë dhe 33.333 lekë

- **Znj.Nertila Spiri** - Zotëron 33.33 % te kapitalit fillestar e barabarte me 1 kuotë dhe 33.333 lekë
- **Z.Julian Canka** - Zotëron 33.34 % te kapitalit fillestar e barabarte me 1 kuotë dhe 33.334 lekë

- Kjo shtese behet per efekt ndarje kuotash por nuk ka fuqi vendim marrese.

7.3. Ortakët e Shoqerise "**UNI TRADE LOGISTIC A.S.**" Sh.p.k pergjigjen për detyrimet ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqerise.

**Neni 8**
**Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga 1 Administrator.

Administator i shoqerise do te jete:

1. **Arian Spiri**, person me shtetësi shqipëtare, e datëlindjes 08/01/1967. Mbajtës i kartës së identitetit me Nr. **G70801034B.**

**Neni 9**
**Viti financiar**

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

**Neni 10**
**Te ardhurat neto**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

**Neni 11**
**Juridiksioni**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar , eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.



CamScanner

Ortaket e Shoqerise

Znj Rudina Bregu

Znj Nertila Spiri

Z. Juljan Canka

**ADMINISTRATORI I SHOQERISE**
**ARIAN SPIRI**

CamScanner